



BULETIN
3- MUJOR/NR.
JANAR - MARS
2008

PASQYRA E TITUVJE
KRYESORË :

1. *Monitorime*
2. *Oponenca ligjore*
3. *Ankesat e qytetarëve dhe reagime të KShH-së*
4. *Veprimtari sensibilizuese për respektimin e të drejtave të njeriut. Mosdikriminimi dhe monoritetet.*
5. *Veprimtari trajnuese – burgjet.*
6. *Të drejtat e emigrantëve në fokusin e KShH-së*
7. *Bashkëpunimi me institucionet shtetërore dhe OJF-të.*
8. *Kritja e aksesit të qytetarëve të KShH-ja.*
9. *Fuqizimi institucional i KShH-së.*

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT
BULETIN

Janar - mars 2008

Ky botim përgatitet në kuadër të transparencës me publikun dhe mundësohet me mbështetjen financiare të CORDAID-it (CATHOLIC ORGANISATION FOR RELIEF AND DEVELOPMENT)

KSHH-JA I ADRESON KRYEMINISTRIT TË VENDIT SITUATËN NË INSTITUCIONET E I PARABURGIMIT

Gjatë muajve nëntor-dhjetor 2007 Komiteti Shqiptar i Helsinkit ndërmori disa vëzhgime në institucionet e paraburgimit dhe në burgje. Bazuar në përfundimet e këtyre vëzhgimeve, KShH-ja ia adresoi shqetësimin për gjendjen në këto vende dhe sugjerimet për përmirësimin e kësaj gjendjeje kryeministri të vendit, ministrin të Drejtësisë dhe drejtorin të përgjithshëm të Burgjeve.....

Vazhdon në faqen 3

ANKESAT E SHTETASVE TE KSHH-JA

Gjatë muajve janar - mars 2008, në kuadër të ndihmës ligjore falas që ofron, KShH-ja ka trajtuar një numër të madh ankesash (rreth 263 ankesa) me objekt: kushtet jo të mira në institucionet e vuajtjes së dënimit, mosrespektimin e afateve të paraburgimit dhe të masave të vlerësimit, ushtrimin e dhunës fizike dhe psikologjike në dhomat e ndalimit dhe të shoqërimit etj.

Vazhdon në faqen 4

RITJIA E BASHKËPUNIMIT NDËRMJET INSTITUCIONEVE SHTETËRORE NË NIVEL LOKAL NË LUFTËN KUNDËR MIGRACIONIT TË PARREGULLT

Në datën 28 shkurt 2008 KShH-ja organizoi në rrethin e Kukësit një tryezë të rrumbullakët me përfaqësues të institucioneve vendore me synim rritjen e ndërgjegjësimit dhe të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve vendore për të parandaluar dhe për të luftuar dukurinë e kalimit të paligjshëm të kufijve.....

Vazhdon në faqen 10

Përgatiti buletin: Erida Skëndaj

Administratore zyre/
Asistente financiare

Redaktimi letrar: Marie Mato

Për më shumë informacion, mund të na kontaktoni në adresën:

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Rr: Gjin Bue Shpata; Pall. 5/1,
Ap.4, Tiranë, P.O Box nr. 1752
web-site: www.ahc.org.al

Tel: 04 233671
Cel: 068 20 23 699;
E-mail: office@ahc.org.al

1. MONITORIME

1.1 MISIONE VËZHGIMI NË PIKAT E KALIMIT TË KUFIRIT

Gjatë muajit janar 2008 KShH-ja vëzhgoi pikat kufitare në: Qafëbotë, Tri Urat dhe portin e Sarandës me qëllim monitorimin e respektimit të të drejtave të emigrantëve shqiptarë nga ana e policisë shqiptare dhe asaj të huaj, si dhe evidentimin e progresit të bërë në krahasim me vëzhgimet e mëparshme. Në fokusin e KShH-së ishte, gjithashtu, vëzhgimi nga afër i infrastrukturës së mjediseve pritëse dhe mjediseve të tjera përreth, faktor ky që ndikon në respektimin e të drejtave të njeriut në këto pika kufitare.

Në këtë kuadër u kryen takime të drejtpërdrejta me drejtues të lartë të policisë, me stafin e policisë kufitare dhe me emigrantë që kalonin në këto pika kufitare. Në përfundim, KShH-ja u prezantoi institucioneve shtetërore përgjegjëse raportin përfundimtar të vëzhgimeve të kryera gjatë periudhës nëntor 2007 - janar 2008 në 12 pika të kalimit të kufirit. Raporti pasqyron përfundimet kryesore për: progresin në fushën ligjore, rekrutimin e personelit femër në pikat kufitare, përmirësimin e kapaciteteve të stafit; problemet lidhur me zbatimin e marrëveshjeve të ripranimit të Shqipërisë me vendet e BE-së; nevojën për përmirësime të mëtejshme të infrastrukturës së pikave kufitare dhe mjediseve pritëse për intervistimin e të deportuarve; mungesën e pajisjeve logjistike dhe teknike që ndikon në punën e personelit të këtyre pikave dhe në respektimin e të drejtave të qytetarëve si dhe fondet e pamjaftueshme financiare për plotësimin e nevojave për ushqim të personave të deportuar.

Në përputhje me problemet e vërejtura, raporti përmban rekomandime dhe sugjerime për marrjen e masave konkrete për përmirësimin e respektimit të të drejtave të emigrantëve shqiptarë dhe të personave të huaj që kalojnë përmes këtyre pikave kufitare.

1.2 MISIONE VËZHGIMI NË INSTITUCIONET PENITENCIARE

Gjatë muajve janar-shkurt 2008 u realizuan vëzhgime në institucionet e paraburgimit dhe të ekzekutimit të vendimeve penale në rrugën "Ali Demi", "Jordan Misja", "Mine Peza", në Vaqar dhe në Durrës. Qëllimi i këtyre vëzhgimeve ishte respektimi i të drejtave të personave të cilëve u është hequr e drejta e lirisë. Në përfundim të vëzhgimeve, KShH-ja doli me një raport të plotë për gjendjen në vendet e paraburgimit brenda vendit dhe sugjerimet përkatëse për përmirësimin e kësaj gjendjeje në të ardhmen në këtë fushë.

1.3 VËZHGIME SPORADIKE DHE TË PLANIFIKUARA NË INSTITUCIONET E VUAJTJES SË DËNIMIT DHE NË DHOMAT E NDALIMIT DHE TË SHOQËRIMIT¹

Në kuadër të ndihmës ligjore falas dhe të ankesave të ardhura në adresë të tij, në periudhën janar-mars 2008 Komiteti Shqiptar i Helsinkit ndërmori disa monitorime në institucionet e vuajtjes së dënimit, në paraburgime dhe komisariate policie.

¹ Këto vëzhgime janë kryer në kuadër të projektit "Për një respektim më të mirë të të drejtave të viktimave", mbështetur nga Komiteti Suedez i Helsinkit.

Bazuar në gjetjet e tyre, KShH-ja i është drejtuar Prokurorisë për hetimin e rasteve të pretenduara, institucioneve të vuajtjes së dënimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Gjithashtu, në periudhën mars-prill 2008 KShH-ja monitoroi dhomat e ndalimit dhe të shoqërimit në 18 komisariate policie. Nga monitorimi u vërejtën probleme të tilla, si: kushtet e këqija, infrastruktura e amortizuar, mungesa e shtretërve, mbipopullimi etj. Vazhdon të jetë shqetësues problemi i qëndrimit në dhomat e ndalimit të personave për të cilët gjykatat e rretheve gjyqësore përkatëse kanë dhënë masa sigurie.

KShH-ja ka kërkuar transferimin e këtyre personave në dhomat e paraburgimit, si nëpërmjet deklaratave publike dhe shkresave të dërguara, ashtu edhe nëpërmjet thirrjeve publike drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, kryeministrit, Ministrisë së Brendshme dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Pas ndërhyrjes së KShH-së kjo gjendje është përmirësuar disi, por përsëri përbën problem.

1.4 RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË PERSONAVE TË PARABURGOSUR KËRKON NDËRHJRJE NGA QEVERIA DHE MINISTRIA E DREJTËSISË

Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka shprehur shqetësimin për gjendjen e konstatuar nga vëzhgimet e fundit të tij në institucionet e paraburgimit dhe në qendrën spitalore në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, nëpërmjet një letre drejtuar: kryeministrit, z. Sali Berisha; ministrit të Drejtësisë, z. Enkelejd Alibeaj dhe zëvendës drejtorit të përgjithshëm të Burgjeve, z Lulëzim Kodra.

Në këtë letër trajtohen problemet e konstatuara nga vëzhgimet e kryera nga KShH-ja gjatë muajve nëntor-dhjetor 2007 në institucionet e paraburgimit dhe burgjeve, përkatësisht në rrethet Berat, Vlorë, Krujë, Kukës, Tropojë, Korçë, Peqin dhe në spitalin e burgut, Tiranë.

Qëllimi i vëzhgimeve ishte të shihej në vend respektimi i standardeve të trajtimit të personave të arrestuar dhe të dënuar, respektimi i të drejtave të tyre në përgjithësi dhe i të miturve dhe grave në veçanti, si dhe përmbushja e rekomandimeve të bëra nga institucionet monitoruese vendëse dhe ndërkombëtare, përfshirë Komitetin Europian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtëruar (CPT). Për më shumë, lexoni letrën e plotë, botuar në www.ahc.org.al

2.0 OPONENCA LIGJORE

Të bindur që respektimi i lirive dhe i të drejtave të njeriut varet edhe nga ligji dhe nga përmbajtja e tij, gjatë periudhës janar- mars 2008 KShH-ja ka ofruar mendime ligjore, parë nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut, dhe sugjerime për projektligje të ndryshme, si: për ndryshimet në ligj për mbrojtjen më të mirë të të miturve; për ndryshime në Kodin penal dhe në ligjin për ekzekutimin e vendimeve penale, për dënimet alternative dhe ngritjen e shërbimit të provës; për projektligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe për ndryshime në ligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e

personave të dënuar dhe të paraburgosur”; për Kodin e etikës për OJF-të në Shqipëri dhe për projektligjin “Për ndihmën ligjore falas”.

KShH-ja u ftua në seanca diskutimi në Komisionin Parlamentar të Ligjeve dhe të Çështjeve Kushtetuese për të shprehur mendimet rreth ndryshimeve në ligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar dhe të paraburgosur”. Nga 15 rekomandimet e bëra nga KShH-ja Komisioni Parlamentar mori në konsideratë 9 prej tyre.

Duke qenë anëtare e Koalicionit Shqiptar për Mbrojtjen e Personave me Aftësi të Kufizuar, KShH-ja jep ndihmesën e vet në përmirësimin e rregullores së këtij koalicioni.


3.0 QYTETETARËT ADRESOJNË ANKESAT E TYRE TE KSHH-JA

3.1 ANKESAT E SHTETASVE TE KSHH-JA

Në kuadër të ndihmës ligjore falas që ofron, gjatë muajve janar – mars 2008 KShH-ja ka trajtuar një numër të madh ankesash (rreth 263 ankesa) me objekt: kushtet jo të mira në institucionet e vuajtjes së dënimit, mosrespektimin e afateve të paraburgimit dhe të masave të vlerësimit, ushtrimin e dhunës fizike dhe psikologjike në dhomat e ndalimit dhe të shoqërimit etj. Gjithashtu, në saje të misioneve të monitorimit të zhvilluara në vendet ku banon minoriteti rom dhe komuniteti egjiptian, janë trajtuar një sërë ankesash lidhur me mungesën e infrastrukturës, mungesën e shërbimeve parësore shëndetësore, mungesën e arsimimit të fëmijëve për shkak të mosregjistrimit të tyre, ndihmën sociale etj.

Për ankesat e adresuara KShH-ja ka ofruar shërbime të ndryshme, si: këshillime ligjore, asistencë në plotësimin e dokumentacionit, verifikime të ndryshme, monitorime të proceseve gjyqësore, ndërhyrje në institucione të ndryshme shtetërore etj. Në rastet e paraqitjes së shkeljeve flagrante të të drejtave të njeriut KShH-ja ka reaguar nëpërmjet deklaratave për shtyp, letrave të hapura, letrave drejtuar institucioneve shtetërore për marrjen e masave etj.

Më poshtë po paraqesim disa paraqitje grafike të cilat tregojnë objektin e ankesave të adresuara te KShH-ja, shërbimet e ofruara si dhe kategorinë e përfituesve.



3.2 KSHH-JA REAGON PUBLIKISHT PËR SHKELJET E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Në periudhën janar-mars 2008 KShH-ja ka dalë me 12 deklarata të pasqyruara në median e shkruar dhe atë elektronike. Deklaratat kanë të bëjnë kryesisht me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si: të drejtat e grave, të punonjësve, të personave të burgosur dhe të paraburgosur, të minoriteteve dhe të komuniteteve, të gazetarëve si dhe me tragjedinë me pasoja të rënda në njerëz dhe materiale, në Gërdec.

4.0 VEPRIMTARI SENSIBILIZUESE PËR RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË NJERIUT

4.1 FESTIVALI NDËRKOMBËTAR I FILMIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË SHQIPËRI / INTERNATIONAL HUMAN RIGHTS FILM FESTIVAL IN ALBANIA (IHRFFA)

Në datat 19-23 mars, Akademia e Filmit dhe e Multimedias “MARUBI”, në bashkëpunim me rrjetin e partnerëve, si: UNICEF, Instituti Shqiptar i Medias, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Agjencia Zvicerane për Zhvillim, OSBE, Terre des Hommes, ARSIS, lëvizja MJAFT, KRIIK Albania si dhe disa prej ambasadave, organizuan edicionin e tretë të Festivalit Ndërkombëtar të Filmit për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri (IHRFFA). Qëllimi kryesor i IHRFFA-së ishte rritja e ndërgjegjësimit të publikut dhe institucioneve shtetërore për një respektim më të mirë të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të grupeve të dobëta të shoqërisë në mënyrë të veçantë.

Në këtë edicion morën pjesë 28 filma të cilët u shfaqën gjatë 5 ditëve, në 29 orë. Filmat pjesëmarrës trajtonin tema të drejtave të njeriut që lidheshin me shoqëritë pastotalitare, minoritetet dhe integrimin, manipulimin e medias etj. Si publiku, ashtu edhe media shfaqën interes të veçantë në ndjekjen e këtij aktiviteti.

4.2 MOSDISKRIMINIMI -NË FOKUSIN E KSHH-SË

4.2.1 AKTIVITETE DHE TAKIME ME PËRFAQËSUES TË MINORITETIT ROM DHE KOMUNITETIT EGJIPTIAN

Në kuadër të misionit sensibilizues dhe ofrimit të shërbimeve ligjore për komunitetin egjiptian dhe minoritetin rom, në periudhën shkurt - mars 2008 u zhvilluan vëzhgime, takime dhe informim ligjor me banorë dhe përfaqësues të organizatave romë dhe egjiptiane në qytetet: Fier, Elbasan, Shkodër, Gjirokastrë, Durrës, Fushë-Krujë, Korçë dhe Tiranë.

Me banorë të komuniteteve përfaqësuesit e KShH-së trajtuan rrugët ligjore për të zgjidhur problemet e tyre dhe për të rivendosur në vend të drejtat e shkelura. Gjithashtu, u arrit të bëhej një njohje më e mirë e veprimtarisë së organizatave vendore që punojnë me minoritetin rom dhe komunitetin egjiptian, u evidentuan problemet e jetës së përditshme të komunitetit egjiptian dhe minoritetit rom, disa prej të cilave u zgjidhën aty për aty, ndërsa pjesa tjetër u referua institucioneve përkatëse.

Bazuar në ankesat dhe shqetësimet e tyre, përfaqësuesit e KShH-së diskutuan me përfaqësues të administratës vendore probleme të tilla, si: taksat, gjelbërimin, banesat, shërbimet sociale për familjet romë dhe egjiptiane, shërbimin shëndetësor si dhe arsimimin për fëmijët e tyre. Problem në këto komunitete mbetet ende mosregjistrimi i fëmijëve të tyre në gjendjen civile çka ndikon në mospërfitimin nga shërbimet sociale dhe ato shëndetësore, si dhe në mosregjistrimin e tyre në shkollë. Edhe papunësia dhe strehimi mbeten sërish probleme shqetësuese për këto komunitete.

Korrespondentët e KShH-së në rrethe, ekspertja e fushës, znj. Zana Sota, anëtare e KShH-së, vullnetarë dhe vetë stafi i brendshëm i këtij komiteti dhanë ndihmesën e tyre për organizimin dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve. Për secilin rreth është përgatitur një raport ku paraqiten të gjitha problematikat dhe shqetësimet e komuniteteve.

4.2.2 PËR NJË SENSIBILIZIM MË TË MIRË TË ORGANEVE TË PUSHTETIT VENDOR LIDHUR ME RESPEKTIMIN E LIRIVE DHE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

Në vijim të aktiviteteve me karakter sensibilizues për minoritetin rom dhe komunitetin egjiptian, në periudhën shkurt - mars 2008, në disa rrethe të Shqipërisë u organizuan takime me drejtues dhe përfaqësues të institucioneve vendore, si komunat, bashkitë dhe prefekturat, me përfaqësues të komisariateve të rretheve përkatëse, përfaqësues të shëndetit parësor dhe atij dytësor, përfaqësues të institucioneve arsimore etj.

Këto takime synonin të bënin të njohura problemet e konstatuara në nivel vendor nga KShH-ja me qëllim përmirësimin e gjendjes dhe respektimin e të drejtave të komunitetit egjiptian dhe të minoritetit rom.

4.2.3 MOSDISKRIMINIMI-SISTEMI I DREJTËSISË DHE ORGANET E ZBATIMIT TË LIGJIT

Në kuadër të sensibilizimit dhe të rritjes së kapaciteteve të punonjësve të sistemit të drejtësisë dhe të policisë për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), KShH-ja, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe ECRI-n, në datat 18-19 shkurt 2008 zhvilluan dy trajnime: një trajnim me gjyqtarë, prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore dhe një tjetër me oficerë të Policisë së Shtetit².

Në të dyja trajnimet u trajtuan çështje të tilla, si: rekomandimet e ECRI-t për sistemin gjyqësor, policinë dhe zbatuesit e ligjeve në Shqipëri; roli i policisë, i prokurorëve dhe i gjyqtarëve në parandalimin dhe luftën e racizmit, intolerancës dhe diskriminimit; legjislacioni shqiptar në fushën e diskriminimit racial dhe intolerancës; probleme të praktikës në Shqipëri.

Në trajnim morën pjesë punonjës të organeve të policisë, të prokurorisë dhe të policisë gjyqësore, të cilët vinin nga rrethet në të cilat ka përqendrim të minoritetit rom dhe të komunitetit egjiptian. Trajnimi u ofrua nga znj. Sarah Burton, juriste pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të ECRI-t; Vasilika Hysi, drejtore ekzekutive e KShH-së dhe anëtare e ECRI-t; znj. Suela Mëneri, juriste, përfaqësuese ligjore pranë organizmave ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut, Ministria e Punëve të Jashtme.

Trajnimi u vlerësua nga pjesëmarrësit për të rehat qe ofroi në fushën teorike dhe praktike, trajtimin e rasteve praktike dhe profesionalizimin e ekspertizës së ofruar.

4.3 RRRITJA E AKSESIT TË MINORITETEVE NË VENDIMMARRJEN VENDORE

4.3.1 VEPRIMTARI TË KSHH-SË NË BASHKITË E TIRANËS, ELBASANIT, FIERIT DHE GJIROKASTRËS PËR RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE TË MINORITETEVE

Për të rritur pjesëmarrjen e minoriteteve në organet e qeverisjes vendore dhe për të përmirësuar shërbimet e këtyre të fundit ndaj grupeve shoqërore më në nevojë, për të rritur kapacitetet e këshillave bashkiakë për hartimin e strategjive efektive për rritjen e aksesit të minoriteteve dhe të grupeve në nevojë, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në bashkëpunim me këshillat bashkiakë të bashkive të Tiranës, Elbasanit, Fierit dhe Gjirokastrës, gjatë periudhës shtator-tetor 2007 organizoi një anketim të qytetarëve dhe të administratës bashkiake të bashkive përkatëse lidhur me respektimin e të drejtave të pakicave në nivel vendor³.

² Kjo veprimtari është zhvilluar në kuadër të projektit të mbështetur nga CORDAID-i.

³ Për më shumë lidhur me përfundimet e dala për secilën bashki, vizito:
<http://www.ahc.org.al/kshh/minoriteti/MINORITETI.html>

Pas përpunimit të të dhënave të dala nga ky anketim, KShH-ja hartoi projektin e parë të raportit i cili u diskutua në tryeza të rrumbullakëta. Ato u mbajtën me shoqërinë civile lokale, në Tiranë, Elbasan, Fier dhe Gjirokastrë me qëllim marrjen e informacioneve, si dhe të përfundimeve dhe rekomandimeve shtesë për problematikën e trajtuar në raport.

Pas diskutimit me grupet e interesit, gjatë muajve shkurt mars 2008 KShH-ja organizoi 4 tryeza të rrumbullakëta në bashkinë e Tiranës, Elbasanit, Fierit dhe Gjirokastrës. Në to ishin të ftuar përfaqësues të bashkive përkatëse, të shoqërisë civile lokale, organizata të minoriteteve, të autoriteteve shtetërore vendore, rrethe intelektualësh, studentë etj. Qëllimi i tryezave ishte diskutimi i përfundimeve kryesore të dala nga raporti si edhe ballafaqimi i tyre ndërmjet aktorëve kryesorë në nivel vendor: autoritetet vendore shtetërore dhe/ose të zgjedhura si edhe shoqëria civile, krijimi i urave të bashkëpunimit në të ardhmen.

Në të gjitha këto aktivitete të organizuara nga KShH-ja ishte e pranishme edhe media që tregoi interes në pasqyrimin e tyre. Pas tryezave të rrumbullakëta, përfaqësues të KShH-së realizuan emisione në televizionet kryesore lokale ku paraqitën përfundimet kryesore të studimit dhe problematikën kryesore për publikun e gjerë.

4.3.2 KONTRIBUT NË FORCIMIN E SHOQATAVE TË EMIGRANTËVE SHQIPTARË NË GREQI

Me qëllimin e mirë për të dhënë ndihmesën në forcimin e shoqatave të emigrantëve shqiptarë në Greqi, në ruajtjen e gjuhës shqipe në radhët e emigrantëve tanë dhe në promovimin e letërsisë sonë në Greqi, KShH-ja kontribuoi në mbledhjen e një sasive të caktuar librash artistikë nga shtëpi të ndryshme botuese. Librat artistikë janë dhuruar nga shtëpia botuese “Çabej” dhe OMSCA-1. KShH-ja gjen rastin t’i falënderojë për ndihmesën e dhënë në ruajtjen e elementeve kombëtare dhe mbështetjen morale të ofruar për emigrantët shqiptarë që jetojnë në Greqi. Këta libra do t’u dhurohen shoqatave shqiptare në Greqi për t’ua ofruar falas emigrantëve tanë.

5. VEPRIMTARI TRAJNUESE NË BURGJE

5.1 TRAJNOHEN DREJTUESIT E LARTË TË INSTITUCIONEVE PENITENCIARE NË SHQIPËRI

Me qëllim përmirësimit e kushteve të burgimit në institucionet e vuajtjes së dënimit dhe konsolidimit e rolit të drejtuesve në këtë drejtim, më 24 janar 2008, KShH-ja, së bashku me ekspertin e vet, z. Jan van den Brand, njohën drejtuesit e lartë të burgjeve me një instrument efektiv për matjen e klimës dhe trajtimin e të dënuarve me dinjitet dhe humanizëm. Instrumenti i auditit evidenton perceptimet e vetë të dënuarve dhe personelit në institucione lidhur me një sërë çështjesh të rëndësishme dhe cilësinë e shërbimeve në institucione. Ky instrument krijon hapësira për institucionet penitenciare dhe DPB-në për të bërë analiza të situatës aktuale në institucione dhe si mund të përmirësohet ajo dhe ofron një qasje të standardizuar, objektive dhe gjithëpërfshirëse. KShH-ja rekomandon që ky instrument të përdoret në disa institucione pilot.

5.2 U TRAJNUAN TRAJNERËT LOKALË SHQIPTARË

Në datat 10-20 mars 2008 KShH-ja organizoi programin "Trajnim trajnerësh në Holandë" i cili kishte për qëllim aftësimin e trajnerëve shqiptarë në trajtimin e të miturve, të grave dhe programet e rehabilitimit në institucionet penitenciare.

Pjesëmarrësit u trajnuan nga 9 trajnerë dhe ekspertë me shumë përvojë në fushën penitenciare dhe të trajnimeve. Prezantimet dhe studimet e rastit u gërshetuan me vizita në 6 paraburgime dhe burgje në vende të ndryshme gjeografike të Holandës. Pjesëmarrësit patën mundësinë të shihnin në praktikë si trajtoheshin të paraburgosurit dhe të dënuarit në Holandë.

Në përfundim, të tria grupet e punës paraqitën një pjesë të trajnimit që ata do të realizojnë me kolegët e tyre në institucionet ku punojnë. Pjesëmarrësit u pajisën me certifikatën përkatëse që dëshmon pjesëmarrjen e tyre dhe me një manual të plotë trajnimi për ta përdorur në trajnimet e tyre të mëtejshme 11 trajnerë.

KShH-ja është vënë në dijeni nga DPB-ja për trajnimet që janë realizuar si dhe për ato që do të realizohen nga trajnerët lokalë në institucionet e tyre në muajt në vijim.

5.3 PROCESI I HARTIMIT TË PROGRAMEVE TË QENDRËS SË TRAJNIMIT TË BURGJEVE (QTB)

Në datat 4-6 shkurt 2008 Komiteti Shqiptar i Helsinkit organizoi një sesion pune për hartimin e programeve të QTB-së, për trajnimin fillestar të punonjësve të rolit bazë të sapopërzgjedhur. Së shpejti do të fillojë funksionimi i tri institucioneve penitenciare të reja, të cilat do të kenë nevojë për punonjës të trajnuar. Qëllimi kryesor i sesionit ishte dhënia e ndihmës konkrete grupit të punës për hartimin e programit 22-ditor të trajnimit të punonjësve të rolit bazë të sapopërzgjedhur në sistemin penitenciar.

Ekspertë ndërkombëtarë me shumë përvojë në këtë fushë, si znj. Jet Hilverdink, trajnere e lartë në qendrën e trajnimit të burgjeve holandeze dhe z. Jan van den Brand, ekspert në fushën penitenciare të Agjencisë Holandeze të Institucioneve të Korrektimit, dhanë kontributin e tyre duke ndihmuar në mënyrë të vazhdueshme grupin e punës.

Grupi shqiptar i punës u njoh hollësisht me metodologjinë e hartimit të programeve bazë, veçanërisht me mënyrën e hartimit të moduleve të trajnimit, udhëzuesve për trajnerët, planet e punës si dhe me librat e punës për studentët/punonjësit që do të trajnohen. Në fund të këtij sesioni pune pjesëmarrësit e grupit të punës ndërmorën angazhimin konkret për të punuar së bashku në katër grupe pune për hartimin e manualit, të librave të punës dhe të planeve të punës për trajnerët. Grupet e punës po vazhdojnë të punojnë për të përmirësuar dhe për të përfunduar versionin paraprak të këtyre materialeve.

5.4 MBËSHTETJE E PROCESIT TË HAPJES SË INSTITUCIONEVE TË BURGUT TË KORÇËS DHE TË PARABURGIMIT NË VLORË

Në datat 25-27 shkurt 2008 dhe 11 prill 2008, KShH, së bashku me ekspertët Jan van den Brand dhe Jacques van Huet, organizuan dy misione pune me stafin drejtues të institucionit të burgut të Korçës dhe të paraburgimit të Vlorës. Gjatë këtyre misioneve u ofrua mbështetje për hapjen dhe funksionimin e këtyre institucioneve. Pjesëmarrësit u njohën me një manual të zbatimit të regjimit në institucion dhe përparësitë e tij. Grupet e

punës pranë këtyre institucioneve po punojnë për hartimin e procedurave të shkruara që do të ndihmojnë në një funksionim të mirë të institucioneve të reja.

6. TË DREJTAT E EMIGRANTËVE NË VËMENDJE TË KSHH-SË

6.1 TRAJTIMI I LETRAVE DHE I ANKESAVE NË FUSHËN E MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË EMIGRANTËVE SHQIPTARË

Me synim mbrojtjen e të drejtave të emigrantëve shqiptarë, gjatë muajve janar-mars 2008 pranë KShH-së vazhdoi të funksionojë linja telefonike në favor të tyre. Në këtë periudhë janë paraqitur dhe janë trajtuar 13 ankesa. KShH-ja u ka ofruar ankuesve këshillime ligjore për mënyrën e zgjidhjes së shqetësimeve të tyre. Gjithashtu, për raste të veçanta, ai u është adresuar institucioneve përgjegjëse shtetërore si edhe organizatave të tjera vendëse dhe ndërkombëtare që ofrojnë shërbime në këtë fushë.

Për një pjesë të ankesave që kishin të bënin me të drejtat e emigrantëve shqiptarë në Greqi, Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka bashkëpunuar me Grupin e Monitoruesit Grek të Helsinkit për trajtimin e tyre. Për ankesat e adresuara në KShH që kishin të bënin me procedurat e ankimit në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg, Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka ofruar këshillime ligjore për procedurat, afatet dhe bazën ligjore që duhet zbatuar.

6.2 NË PARANDALIMIN E MIGRACIONIT TË PARREGULLT ROLI TË VEÇANTË LUAN SHKOLLA

Në datën 27 shkurt 2008 KShH-ja organizoi një tryezë të rrumbullakët në rrethin e Kukësit me temë "Roli edukues i shkollës në ndërgjegjësimin e të rinjve për parandalimin e migracionit të parregullt"⁴. Qëllimi i tryezës ishte rritja e rolit të shkollës në ndërgjegjësimin e të rinjve për parandalimin e migracionit të parregullt dhe në informimin më të mirë të tyre për mundësitë e migracionit të rregullt.

Nga diskutimet në tryezë u evidentua niveli i ulët i njohurive dhe i informacionit të mësuesve dhe të rinjve për mundësitë ligjore për migrimin e rregullt, për rreziqet dhe pasojat me të cilat shoqërohej migrimi i parregullt, si dhe nevoja e botimit të materialeve informuese dhe sensibilizuese, e angazhimit të të gjithë aktorëve për ndërgjegjësimin e të rinjve dhe e organizimit të trajnimeve profesionale për të rinjtë që duan të migrojnë jashtë vendit për qëllime punësimi. KShH-ja evidentoi nevojën e angazhimit më efektiv të institucioneve shtetërore vendore, të shoqërisë civile si dhe të medias në bashkërendimin e tyre për një sensibilizim më të mirë të shoqërisë dhe të rinjve.

Në përfundim të tryezës, KShH-ja u prezantoi institucioneve përgjegjëse shtetërore disa nga përfundimet dhe rekomandimet kryesore me qëllim marrjen e masave konkrete për luftimin e migracionit të parregullt.

⁴ Ky aktivitet u realizua me mbështetjen financiare të dy partnerëve të KShH-së, CORDAID-it dhe Komitetit Norvegjez të Helsinkit..

Në këtë tryezë kontribuan me pjesëmarrjen e tyre përfaqësues të drejtorisë arsimore, drejtuesit e të gjitha shkollave të mesme dhe 9-vjeçare të rrethit të Kukësit, mësuesit e lëndëve sociale, psikologët si edhe përfaqësues nga bordet e prindërve dhe qeveritë e nxënësve.

7 BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET SHETËRORE DHE OJF-TË

7.1 RITJA E BASHKËPUNIMIT NDËRMJET INSTITUCIONEVE SHETËRORE NË NIVEL VENDOR NË LUFTËN KUNDËR MIGRACIONIT TË PARREGULLT

Me synim rritjen e ndërgjegjësimit dhe të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve vendore si dhe mes këtyre të fundit dhe aktorëve të shoqërisë civile dhe medias për të parandaluar dhe për të luftuar fenomenin e kalimit të paligjshëm të kufijve , në datën 28 shkurt 2008 Komiteti Shqiptar i Helsinkit organizoi në rrethin e Kukësit një tryezë të rrumbullakët me përfaqësues të institucioneve vendore⁵.

Disa nga çështjet e diskutuara në tryezë ishin: faktorët nxitës të migrimit të parregullt, si: varfëria, niveli i lartë i papunësisë dhe mungesa e informacionit për format e ligjshme të migrimit; roli i shoqërisë civile dhe i donatorëve të huaj në përmirësimin e gjendjes ekonomike dhe zbutjen e papunësisë; rritja e buxhetit të organeve vendore për trajtimin më të diferencuar të këtij rrethi; bashkëpunimi me biznesin vendës për nxitjen e punësimit si dhe rritja e rolit të zyrës rajonale të shërbimit të punësimit në hartimin dhe zbatimin e politikave efikase të punësimit.

Në tryezë morën pjesë përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, departamenti i kufirit dhe i migracionit, përfaqësues të nivelit të lartë të institucioneve shetërore në nivel vendor, si nga: bashkia, prefektura, këshilli i qarkut, drejtoria e policisë së qarkut, zyra rajonale e shërbimit të punësimit dhe shërbimit social si dhe përfaqësues të organizatave jofitimprurëse vendëse.

Përfundimet dhe sugjerimet kryesore të tryezës KShH-ja ua bëri të njohura institucioneve përgjegjëse shetërore me synim marrjen e masave konkrete për garantimin e lëvizjes së lirë dhe të rregullt të qytetarëve.

7.2 KOALICIONI SHQIPTAR “AFTËSIA E KUFIZUAR DHE ZHVILLIMI”

Në muajin shkurt 2008 një grup organizatash të të drejtave të njeriut, ndër të cilat edhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit, krijuan koalicionin shqiptar “Aftësia e kufizuar dhe zhvillimi”. Qëllimi i krijimit të këtij koalicioni ishte promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar nëpërmjet bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit dhe ekspertizës mes anëtarëve për përfshirjen e problematikës së aftësisë së kufizuar në programet e zhvillimit.

Në këtë kuadër janë zhvilluar disa takime ndërmjet anëtarëve të koalicionit me synim konsolidimin dhe miratimin e strukturave drejtuese të tij për një mirëfunksionim

⁵ Veprimtaria u mundësua falë mbështetjes financiare të partnerëve të KShH-së, CORDAID-it dhe Komitetit Norvegjez të Helsinkit.

në të ardhmen. Veprimtaria e koalicionit do të bazohet në një marrëveshje të përbashkët të miratuar nga të gjithë anëtarët e tij.

Një ndër iniciativat e koalicionit ishte përgatitja e një letre të hapur e cila iu dërgua të gjitha institucioneve shtetërore përgjegjëse me synim nxitjen e përmirësimit të Kodit zgjedhor për garantimin e respektimit të së drejtës së votës të personave me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, me ndihmën e Avokatit të Popullit, ky koalicion po kontribuon në ndërgjegjësimin dhe ushtrimin e presionit ndaj institucioneve përgjegjëse shtetërore për miratimin e statusit ligjor për personat me aftësi të kufizuara mendore.

7.3 RRRITJA E BASHKËPUNIMIT TË KSHH-SË ME OJF-TË LOKALE⁶

Në vazhdim të rritjes së aksesit dhe bashkëpunimit të OJF-ve lokale me KShH-në, gjatë muajit shkurt dhe mars 2008 korrespondentët e KShH-së në Shkodër dhe në Fier organizuan takime me OJF-të lokale të të drejtave të njeriut. Fillimisht u prezantuan objektivat e KShH-së në përgjithësi dhe më gjerësisht lidhur me shërbimin ligjor që ofron ky komitet nëpërmjet klinikës ligjore. Gjatë takimeve për të pranishmit u shpërndanë materiale sensibilizuese dhe informuese për të drejtat e njeriut dhe misionin e KShH-së.

7.4 PËSËMARRJA NË TAKIME DHE MBLEDHJE KOORDINUESE

Si anëtare e Konsorciumit Ndërkombëtar, me qëllim përditësimin dhe koordinimin më të mirë të veprimtarive me aktorë të tjerë vendës dhe të huaj, si dhe për të dhënë një ndihmesë edhe më të madhe në fushën e respektimit të lirive dhe të të drejtave të njeriut dhe sensibilizimit të institucioneve vendëse dhe të huaja që veprojnë në Shqipëri, KShH-ja ka marrë pjesë në mbledhjet e këtij konsorciumi në fushën e burgjeve, të reformës ligjore dhe të drejtësisë së të miturve.

8. RRRITJA E AKSESIT TË QYTETARËVE TE KSHH-JA

8.1 MEDIA ELEKTRONIKE DHE E SHKRUAR- PARTNERË TË KSHH-SË NË SENSIBILIZIMIN DHE EDUKIMIN E PUBLIKUT ME TË DREJTAT E NJERIUT

Për të rritur aksesin e qytetarëve të KShH-ja në nivel vendor, gjatë periudhës janar - mars 2008, korrespondentët e këtij komiteti në rrethet Korçë, Shkodër, Elbasan, Gjirokastrë dhe Fier prezantuan në mediat lokale veprimtarinë e KShH-së, shërbimet ligjore falas që ofron, problematikat e gjetura dhe masat konkrete që janë marrë për zgjidhjen e tyre.

Mjetet që shërbyen për sensibilizimin e publikut, ishin gazetat lokale, si: "Nositi" (e Korçës), "Java Elbasan" dhe "Ku vemi" (të Elbasanit), "Albania", "Integrimi" dhe "Telegraf" (të Tiranës).

Gjatë muajve janar - shkurt 2008 KShH-ja organizoi disa emisione në TV dhe radio lokale për të informuar qytetarët për shërbimet që ofron në fushën e ndihmës ligjore. U zhvilluan 4 emisione në TV dhe radio lokale, si në: TV "Magic Star" (Korçë), TV

⁶ Aktivitetet janë realizuar në kuadër të projektit "Për një mbrojtje më të mirë të viktimave të të drejtave të njeriut" - Klinika ligjore, mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit.

SKAMPA (Elbasan), TV ROZAFI (Shkodër) dhe TV KOMBI (Fier). Gjithashtu, korrespondentët e KShH-së informuan dëgjuesit për problematikën e konstatuar në rrethet përkatëse.

Gjatë takimeve me gazetarët u diskutua për format e bashkëpunimit në të ardhmen për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe për rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura.

9. FUQIZIMI INSTITUCIONAL I KSHH-SË

9.1 TRAJNIMI I MONITORUESVE TË GJYKATAVE

Nisur nga problemet me të cilat përballet sistemi i drejtësisë shqiptare dhe për të dhënë ndihmesën e vet në respektimin më të mirë të të drejtave të shtetasve nga sistemi gjyqësor, KShH-ja organizoi trajnimin "Aspekte ligjore dhe praktike për monitorimin e gjykatave".

Disa nga çështjet e trajtuara ishin: metodologjia e monitorimit, procesi i rregullt ligjor, aspekte të organizimit të pushtetit gjyqësor, funksionet e gjykatave, të drejtat e qytetarëve dhe aksesit i tyre në gjykatë, roli i OJF-ve në monitorimin e gjykatave dhe më konkretisht roli i KShH-së, legjislacioni i sistemit gjyqësor në Shqipëri dhe zbatimi i tij në praktikë, si dhe kuptimi dhe zbatimi i nenit 5 dhe 6 të KEDNJ-së .

Ekspertët sollën përvojën e tyre nga vende të tilla, si: Suedia, Maqedonia, Turqia.

Në këtë trajnim dhanë ekspertizën znj. Ulrika Borg dhe Violeta Velkovska, si dhe prof. Arta Mandro, drejtoreshë e Shkollës së Magjistraturës.

Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin studentët të Fakultetit të Drejtësisë, juristë të rinj, juristë nga organizata të ndryshme, korrespondentët e KShH-së si dhe avokatë të disa rrethëve.

Trajnimi u zhvillua në datat 20 dhe 21 mars 2008⁷.

9.2 VIZITË STUDIMORE LIDHUR ME RESPEKTIMIN E TË DREJTAVE DHE INTEGRIMIN NË SHOQËRI TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR (DUBLIN, 2-9 MARS 2008)

Gjatë muajit mars 2008, misioni USAID në Shqipëri mundësoi organizimin e një vizite studimore njëjavore në Dublin të disa anëtarëve të koalicionit shqiptar "Aftësia e kufizuar dhe zhvillimi" lidhur me respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Organizimi i kësaj vizite u krye në kuadër të forcimit dhe rritjes së kapaciteteve profesionale të anëtarëve të koalicionit për të përmirësuar aksesin e njerëzve me aftësi të kufizuara në Shqipëri për shërbimet komunitare.

Vizita synoi studimin dhe njohjen me modelet që ekzistojnë në Dublin për shërbimet komunitare në favor të personave me aftësi të kufizuara, trajnimet profesionale dhe format e punësimit të tyre si dhe mbrojtjen efektive të të drejtave dhe interesave të kësaj kategorie shtetasish pranë organeve administrative dhe gjyqësore të krijuara për mbrojtjen e tyre. Në përfundim të kësaj vizite studimore secili pjesëmarrës hartoi një plan veprimi 6-mujor për format e ndihmesës dhe të bashkëpunimit ndërmjet tyre për përmirësimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri.

⁷ Ky trajnim u zhvillua në kuadër të projektit "Trial Monitoring Training", mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit.

Në këtë vizitë studimore morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Punës, e Çështjeve Sociale dhe e Shanseve të Barabarta, si organi përgjegjës shtetëror për këtë kategori shtetasish, nga Avokati i Popullit si edhe nga disa organizata të të drejtave të njeriut që punojnë në këtë fushë. Përfaqësuese e KShH-së në këtë vizitë studimore ishte znj. Ersida Sefa.

9.3 SHKËMBIM PËRVOJE DHE RITJE E KAPACITETIT TË STAFIT TË KSHH-SË NËPËRMJET VIZITAVE STUDIMORE NË ORGANIZATAT PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË RAJON

Në datat 20 - 23 shkurt dhe 4 - 8 mars 2008, znj. Etilda Saliu, koordinatore e shërbimit ligjor falas pranë KShH-së kreu vizita studimore në Komitetin Maqedonas të Helsinkit në Shkup, Maqedoni; në organizatën Dalmatian Solidarity Committee, Split, Kroaci, si dhe në Komitetin Kroat të Helsinkit, Zagreb, Kroaci.

Gjatë këtyre vizitave znj. Saliu u takua me drejtues dhe anëtarë të personelit të këtyre organizatave, studioi dosje nga praktika e tyre dhe mori pjesë në takimet e drejtpërdrejta të stafit me klientët që kërkonin ndihmë juridike. Këto aktivitete janë në vazhden e aktiviteteve për rritjen e kapaciteteve të stafit të klinikës ligjore të KShH-së, të mundësuar nga Komiteti Suedez i Helsinkit.

Kjo përvojë do të shërbejë në të ardhmen në përmirësimin e organizimit të punës së përditshme si dhe në ofrimin e ndihmës ligjore falas.

9.4 PËR NJË MENAXHIM STRATEGJIK TË ORGANIZATËS

Në datat 24- 30 mars 2008, znj. Vasilika Hysi, drejtore ekzekutive e KShH-së, mori pjesë në trajnimin e organizuar për menaxherë të lartë nga Universiteti i Harvardit, Kolegji i Kembrixhit në Athinë. Në trajnim morën pjesë përfaqësues nga organizata të ndryshme të rajonit dhe më gjerë. Trajnimi ofronte mundësi për një menaxhim më strategjik të organizatave nga vinin pjesëmarrësit. KShH-ja falënderon fondacionin KOKALIS dhe Universitetin e Nju-Jorkut në Tiranë për mbështetjen financiare të dhënë.